



REPUBLIKA E KOSOVËS
Komuna e Malishevës



Drejtoria e Administratës së Përgjithshme
Nr:03/
Datë:10.07.2017

Aktvendimet e Kryetarit të Komunës së Malishevës, z. Ragip Begaj për muajin Qershor-2017.

Aktvendim me nr.të prot.01/690, lejohen mjetet financiare në shumë prej 725.00 euro, mjetet lejohen në emër të furnizimit me ujë të pijes për nxënësit, administruesit, komisionarët dhe shërbimi teknik për pjesëmarrje në testin e maturës shtetërore, afati Qershor -2017.

Aktvendim me nr.të prot.01/691, për iniciimin e procedurave të prokurimit publik, lejohen mjetet financiare në shumë prej 850.00 euro, në emër të organizimit të transportit për administratorët e testit të maturës shtetërore 2017.

Aktvendim me nr. të prot.01/692, për iniciimin e procedurave të prokurimit publik, lejohen mjetet financiare në shumë prej 1,948.00 euro, në emër të furnizimit shtesë me dhjetë makina mjelëse për përkrahjen e fermerëve të Komunës së Malishevës.

Aktvendim me nr.të prot.01/693, lejohen mjetet financiare në shumë prej 990.00 euro, në emër të furnizimit me materiale të ndryshme për mirëmbajtjen e veturave zyrtare të administratës së Komunës së Malishevës.

Aktvendimi me nr. të prot.01/694, lejohen mjetet financiare në shumë prej 975.00 euro, mjetet lejohen në emër të furnizimit me një pomë uji për nevoja të shkollës fillore në fshatin Llapqevë, KK- Malishevë.

Aktvendimi me nr. të prot.01/636, lejohen mjetet financiare në shumë prej 400.00 euro, mjetet lejohen në emër të familjes së Aziz Vrenesit nga fshati Marali për tejkalimin e gjendjes së vështirë ekonomike dhe sociale.

Aktvendimi me nr. të prot.01/701, lejohen mjetet financiare në shumë prej 300.00 euro, lejohen mjetet financiare në emër të kërkesës nr.01/636, të dates 19.05.2017, e parashtruar nga z.Sinan Gashi, nga fshati Balincë, KK- Malishevë.

Aktvendimi me nr. të prot.01/702, të zotohen mjetet në shumë prej 995.00 euro, mjetet lejohen në emër të renovimit të objektit të QMF-së në fshatin Kijevë.

Aktvendimi me nr.të prot.01/703, lejohen mjetet financiare në shumë prej 410.00 euro, mjetet lejohen në emër të furnizimit me material higjienik për nevojat e drejtorisë për mbrojtje dhe shpëtim.

Aktvendimi me nr. të prot.01/704, lejohen mjetet financiare në shumë prej 980.00 euro, lejohen mjetet në emër të Institutit për Studime Ndërkombëtare –Agora. Mjetet lejohen sipas rekomandimit të drejtorisë së kultures, rinisë dhe sportit, në emër të realizimit të projektit „Thuaj jo ekstremizimit”.

Aktvendim me nr. të prot.01/705, lejohen mjetet financiare në shumë prej 232.50 euro, mjetet lejohen në emër të mbulimit të shpenzimeve për ushqim dhe pije të shkaktuara nga drejtoria për arsim dhe edukim, me rastin e ushtrimit të aktiviteteve zyrtare.

Aktvendimi me nr. të prot.01/224, lejohen mjetet financiare në shumë prej 300.00 euro, mjetet lejohen në emër të z. Fadil Dobruna nga fshati LLozicë- Komuna e Malishevës, ndihma llogaritet momentale për parashtruesin e kërkeses së lartëcekur.

Aktvendimi me nr. të prot.01/715, lejohen derivatet e naftës deri në sasi prej 50 litra, në emër të miratimit të kërkesës nr.01/710, dt.07.06.2017, e parashtruar nga Shoqata e të Verbërve në Malishevë, për pjesëmarrje në zgjedhjet e Qershorit -2017.

Aktvendimi me nr. të prot.01/717, miratohet arsyeshmëria për punë shtesë e përgatitur nga shërbimet profesionale të drejtorisë për urbanizëm, përkatësishtë menaxheri i projektit, të kontratës Kornizë në lidhje me aktivitetin e prokurimit publik,, Mirëmbajtja e rrugëve të fshatrave dhe qytetit gjatë sezonit dimëror” sipas prokurimit nr.Ma-62500-16-174-221.

Aktvendimi me nr. të prot.01/718, lejohen mjetet financiare në shumë prej 992.50 euro, mjetet lejohen në emër të punimit, pastrimin dhe rregullimin e pllakës së martirëve në parkun e qytetit, në Malishevë.

Aktvendimi me nr. të prot.01/719, formohet komisioni për verifikimin e punimeve të projektit „Renovimi i këndit të lojrave për fëmijë”, në sheshin „ Sheshi i Dëshmorëve” Malishevë.

1. Qlirim Karaqica -kryetar, 2. Remzi Javor- anëtar, 3. Antigona Morina- anëtar.

Aktvendimi me nr.të prot.01/729, inicimi i procedurave të prokurimit publik, lejohen mjetet financiare në shumë prej 362,618.00 euro, mjetet lejohen në emër të realizimit të projektit, asfaltimi i rrugës te ujëvarat e Mirushës, në gjatësi prej L=3100 m dhe gjerësi =6.0 m. Sipas Memorandumit të Mirëkuptimit, i lidhur në mes të Komunës së Malishevës dhe Ministrisë së Infrastrukturës, Mem.nr.01/506, dt.21.04.2017, 176/17, 21.04.2017.

Aktvendimi me nr. të prot.01/ 731, lejohen mjetet financiare në shumë prej 408.00 euro, mjetet lejohen në emër të mëditjes me rastin e udhëtimit jashtë vendit të kryetarit të komunës së Malishevës, dhe zyrtarit të drejtorisë për arsim dhe edukim z. Shefqet Kryeziu, në Gjermani.

Aktvendimi me nr. të prot.01/734, lejohen mjetet financiare në shumë prej 5,988.50 euro, mjetet lejohen në emër të organizimit të dezinfektimit selektiv shtesë (10% i kontratës) të zonave endemike në territorin e komunës së Malishevës.

Aktvendimi me nr. të prot.01/735, miratohet arsyeshmëria për punë shtesë nr.05/215, dt.08.06.2017, për realizimin e punimeve të objektit të shkollës në fshatin Berishë, KK-Malishevë. Në emër të realizimit të arsyeshmërisë për punë shtesë të parashtruara sipas specifikacionit të cekur në nenin 1 të këtij aktvendimi, lejohen mjetet financiare në shumë prej 12,084.31 euro.

Aktvendimi me nr. të prot.01/736, lejohen mjetet financiare në shumë prej 992.00 euro, lejohen mjetet në emër të transportit të nxënësve me kushte të rënda ekonomike dhe sociale të Lagjës – Garaqevë fshati Panorc- KK Malishevë.

Aktvendimi me nr. të prot.01/737, lejohen mjetet financiare në shumë prej 945.00 euro, mjetet lejohen në emër të riparimit të pajisjeve medicinale të QKFM-së , „ Shpëtim Robaj” Malishevë.

Aktvendimi me nr. të prot.01/739, të zotohen mjetet në shumë prej 1,900.00 euro, mjetet lejohen në emër të përkrahjes financiare për aktivitetet arsimore, edukative, dhe kulturore të cilat i kushtohen nxënësve maturan, si Qendra e Kompetencës „ Kujtim Krasniqi”, si dhe gjimnazi „Hamdi Berisha “ dhe „Lasgush Poradeci” në fshatin Kijevë.

Aktvendimi me nr. të prot.01/668, lejohen mjetet në shumë prej 618.00 euro, mjetet lejohen në emër të pagesës së shpenzimeve të udhëtimit (biletat kthyesë të aeroplanit) të z. Arton dhe Aurora Begaj, nga fshati Banjë, KK- Malishevë.Mjetet ndahen sipas kërkesës nr.01/668, dt.29.05.2017, të parashtruar nga z. Arton Begaj, për mbulimin e një pjese të shpenzimeve të shërimin të djalit (Aurorit), i cili sipas dokumentacionit të palës së lartcekur do të trajtohet në Republikën e Turqisë, ndërsa mjetet nga komuna e Malishevës, përfshin vetëm mbulimin e shpenzimeve të biletës së udhëtimit me aeroplan.

Aktvendimi me nr. të prot. 01/740, lejohen mjetet financiare në shumë prej 1,320.00 euro, mjetet lejohen në emër të organizimit të transportit për nevojat e stafit të QKMF-së, me rastin e realizimit të ekskursionit në Republikën e Shqipërisë.

Aktvendimi me nr. të prot.01/720, miratohet arsyeshmëria për punë shtesë e përgatitur nga shërbimet profesionale të drejtorisë së urbanizmit „ Punimi i kanalizimit në fshatrat Carrallukë dhe Mleqan sipas prokurimit nr.Ma-62500-17-023.521, kontrata nr.20, prot.03/43.

Aktvendimi me nr. të prot.01/721, lejohen mjetet financiare në shumë prej 900.00 euro, lejohen mjetet sipas kërkesës së parashtruar nga subjekti i lartcekur me nr.12/49, dt.23.05.2017.

Aktvendimi me nr. të prot.01/722, lejohen mjetet financiare në shumë prej 200.00 euro, mjetet lejohen në emër të miratimit të kërkeses nr.12/48, dt.16.05.2017, për përkrahjen e z. Grevist Bytyqi nga fshati Kërvasari, KK- Malsihevë.

Aktvendimi me nr. të prot.01/723, lejohen mjetet financiare në shumë prej 218.863.00 euro, mjetet lejohen në emër të realizimit të projektit asfaltimi i rrugës që lidhë fshatrat Mleqan – Pllloqicë, KK- Malishevë, në gjatësi prej L=2200 m dhe gjerësi =5.0 m.

Aktvendimi me nr. të prot.01/760, lejohen mjetet financiare në shumë prej 990.00 euro, mjetet lejohen në emër të mbulimit të shpenzimeve për ushqim dhe pije për nxënësit me nevoja të veqanta të klasave të bashkangjitura në Malishevë, periudha Janar-Qershor.

Aktvendimi me nr. të prot.01/761, lejohen mjetet financiare në shumë prej 330.00 euro, në emër të organizimit të transportit për nxënësit me nevoja të veqanta të shkollës fillore të mesme „Ibrahim Mazreku”, KK- Malishevë.

Aktvendimi me nr. të prot.01/762, lejohen mjetet financiare në shumë prej 990.00 euro, mjetet lejohen në emër të organizimit të transportit të nxënësve të shkollës fillore të mesme të ulët „ Ismail Qemali” fshati Bellanicë, KK- Malishevë.

Aktvendimi me nr. të prot.01/763, lejohen mjetet financiare në shumë prej 4,247.50 euro, mjetet lejohen në emër të furnizimit shtesë me sera biznesore për nevojat e fermerëve të Komunës së Malishevës.

Aktvendimi me nr. të prot.01/764 , lejohen mjetet financiare prej 183.03 euro, mjetet lejohen në emër të servisimit të automjetit kombi me targa 07/239-CB, që menaxhohen nga ana e drejtorisë për shëndetësi dhe mirëqenie sociale, përkatësisht për nevoja të Hemodializës, në KK- Malishevë.

Aktvendimi me nr. të prot.01/740, lejohen mjetet financiare në shumë prej 990.00 euro, mjetet lejohen në emër të organizimit të transportit për nevojat e stafit të QKMF-së, me rastin e realizimit të ekskursionit në Republikën e Shqipërisë.

Aktvendimi me nr. të prot.01/566, lejohen mjetet financiare në shumë prej 250.00 euro, mjetet lejohen në emër të ndihmës momentale për z. Ramadan Bekolli nga fshati Marali, KK-Malishevë.

Aktvendimi me nr. të prot.01/780, lejohen mjetet financiare në shumën prej 870.00 euro, mjetet lejohen në emër të pagesës së mjeteve financiare sipas kontratës nr.11/48, dt.30.01.2017, lidhur në mes të Drejtorisë për Arsim dhe Edukim dhe znj. Shpresa Xhyliqi nga fshati Marali, me qëllim të ushtrimit të kryerjes së punëve dhe detyrave të punës edukatore në SH.F.M.U „ Vesel Pagarusha” në Pagarushë, KK- Malishevë.

Aktvendimi me nr. të prot. 01/779, lejohen mjetet financiare në shumë prej 525.00 euro, mjetet lejohen në emër të rregullimit të veturës Shkoda me tabela zyrtare 07Z-13-30, pronë publike e KK- Malishevë. Mjetet lejohen sipas kërkeses së parashtruar nga drejtoria e shëndetësisë.

Aktvendimi me nr. të prot.01/781, miratohet arsyeshmëria për punë shtesë e përgatitur nga shërbimet profesionale të drejtorisë për urbanizëm, përkatësisht menaxheri i projektit rregullimi i varrezave të vitit 1919, në fshatin Qypevë.

Aktvendimi me nr. të prot.01/782, lejohen mjetet financiare në shumë prej 755.50 euro, mjetet lejohen në emër të sigurimit kasko i automjetit kombi me targa 07/296-AK. Që menaxhohen nga ana e drejtorisë për shëndetësi dhe mirëqenie sociale, KK- Malishevë.

Aktvendimi me nr. të prot.01/784, miratohet arsyeshmëria për punë shtesë e përgatitur nga shërbimet profesionale të drejtorisë për urbanizëm, përkatësisht menaxheri i projektit rregullimi i ndriqimit publik nëpër lagjet e qytezës së Malishevës, sipas kontratës nr.33, dt.07.06.2017, protokoli nr.03/57.

Aktvendimi me nr. të prot.01/786, lejohen mjetet financiare në shumë prej 1000.00 euro, mjetet lejohen në emër të miratimit të kërkeses nr.10/12, dt.27.06.2017, parashtruar nga drejtoria për mbrojtje dhe shpëtim, për implementimin e projektit të quajtur ushtrimi fushor „ Mirusha 2017”.

Aktvendimi me nr. të prot.01/793, për inicimin e procedurave të prokurimit publik, lejohen mjetet financiare në shumë prej 220.00 euro, mjetet lejohen në emër të furnizimit me material ushqimor për familjet skamnore të komunës së Malishevës.

Aktvendimi me nr. të prot.01/792, për inicimin e procedurave të prokurimit publik, për zhvelimin e aktivitetit të prokurimit në lidhje me përzgjedhjen e operatorit ekonomik për nevojat e drejtorisë për shëndetësi, përkatësisht QKMF-së, „Shpëtim Robaj”- Malishevë.

Aktvendimi me nr. të prot.01/787, lejohen mjetet financiare në shumë prej 125.40 euro, mjetet lejohen në emër të mëditjeve zyrtare me rastin e pjesëmarrjes në trajnimin e organizuar nga Instituti për Qeverisje Lokale në Prishtinë. Mëditjet janë të parapara për 3 (tri) ditë në Republikën e Maqedonisë, sipas Udhëzimit Administrativë për mëditje jashtë vendit, lëshuar nga Ministria e Financave të Republikës së Kosovës.

Aktvendimi me nr. të prot.01/789, lejohen mjetet financiare në shumë prej 4,500.00 euro, mjetet lejohen në emër të furnizimit me (14) klima për nevoja të drejtorisë së administratës komunale dhe nevojat e QKMF-së, „ Shpëtim Robaj” në Malishevë.